



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYETARI

Nr. 2106 prot.

Himarë, më 05.03. 2025

**URDHËR**

Nr. 177. Datë 05.03/2025

**PËR**

**“PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË  
HIMARË PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA  
SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE MATERIALEVE EDUKUESE ZGJEDHORE”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në pikën 3 të nenit 22, të ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 10019/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, (i përditësuar), dhe udhëzimit nr.6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

**U R D H Ë R O J:**

1. Përcaktimin si vende të afishimit të materialeve edukuese dhe informuese, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së) ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar, ambjentet pranë zyrave të njësive administrative të Bashkisë Himarë.

2. Përcaktimin si vende të afishimit të materialeve propagandistike zgjedhore vendet publike në territorin e bashkisë në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.

- Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).

- Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
- Ndalohet vendosja e materialeve propagandastike në mjete që operojnë në transportin publik.
- Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.

3. Ngarkohet Drejtoria e Policisë Bashkiake dhe administrata e bashkisë për garantimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë urdhër.

4. Ngarkohet specialisti i transparencës dhe i konsultimit publik për publikimin e këtij urdhri në faqen e internetit të bashkisë brenda 24 orësh nga miratimi i tij.

5. Ngarkohet Drejtoria Juridike për njoftimin e një kopje të këtij urdhëri Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet brenda 24 orësh nga miratimi i tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

Vangjel Tavo



*Konc: A.Muhametaj*